

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"SHADE" Sh.p.k.**

Sot më datë 22.06.2022, në Tiranë palët e mëposhtme:

- **Shoqëria "EMU Group" S.p.A.**, shoqëri e se drejtes italiane, e regjistruar ne regjistrin e shoqerive ne Perugia, Itali, me kod fiskal dhe numer te regjistrimit: 03765320969, me seli ligjore ne Zona Industriale Schiavo, Marsciano (PG), CAP 06055, Itali, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor z. Giorgio Comodi, qytetar italian, i biri i Giovanni, i datëlindjes 17.10.1958 mbajtës i katës së identitetit Italiane Nr. AY 7875357 e leshuar nga Komuna e Marsciano, autorizuar me Vendim te Keshillit te Administrimit date 17.05.2022 i pajisur me apostille n. 930/2022, madhor dhe me zotësi juridike te plote për të vepruar;
- **z. Roland Profiti**, qytetar shqiptar, i biri i Jorgji, i datëlindjes 13.02.1967 , banues ne Lagjia 16, Rruga "Hysen Kertusha", Banese Private, Durrës me leternjoftim shqiptar me Nr. 033854608 dhe Nr. Personal G70213142T madhor dhe me zotësi juridike te plote për të vepruar..

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet (më poshtë "Shtojca 1").

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është "SHADE" Sh.p.k.

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Xhafzotaj, Ndertese me Numer Pasurie 49/58-ND, Zona Kadastrale Nr. 3852, Vol. 17, Faqe 50, Durrës, Shqipëri.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë do të jetë me afat te pacaktuar.

Neni 4 – Objekti i shoqërisë

- 4.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve prodhuese e tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 4.2. Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka per objekt: (i) prodhimin e çadrave, pjergullave, belvederëve, velave dhe mbulesave në përgjithësi; (ii) kryerje përpunimi mekanik dhe tapiceri për llogari të palëve të treta; (iii) import eksporti e lidhur me aktivitetin; .
- 4.3. Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të dobishëm ose funksional për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 4.1 më sipër.

Neni 5 – Kapitali themeltar





- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është € 300 000,00 (treqind mijë/00 euro).
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë sipas nenit 6 të Akti të Themelimit.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Shoqëria "EMU Group" S.p.A., ka ofruar një kontribut në para të barabartë me € 195.000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë / 00 euro) në favor të shoqërisë në themelim e sipër në këtë mënyrë: shuma prej € 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë euro), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Intesa SanPaolo Bank Sh.A, në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe pjesa e mbetur prej € 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) do të dredhet brenda datës 31.12.2023.
- Z. Roland Profiti, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me € 105.000 (njëqind e pesë mijë / 00 euro) në favor të shoqërisë në themelim e sipër në këtë mënyrë: shuma prej € 70.000 (shtatëdhjetë mijë euro), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Intesa SanPaolo Bank Sh.A, në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe pjesa e mbetur prej € 35.000 (tridhjetë e pesë mijë euro) do të dredhet brenda datës 31.12.2023.

6.2. Sipas kontributeve të mësipërme:

- Shoqëria "EMU Group" S.p.A., i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 65% (gjashtëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Z. Roland Profiti, i përket 1 (një) kuota, që i korrespondon 35% (tridhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 – Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 – Administrimi

8.1 Me këtë akt emërohen 3 (tre) Administratorë të Shoqërisë si më poshtë:

- z. **Roland Profiti**, qytetar shqiptar, i biri i Jorgji, i datëlindjes 13.02.1967, banues ne Lagjia 16, Rruga "Hysen Kertusha", Banese Private, Durrës me letërnjoftim shqiptar me Nr. 033854608 dhe Nr. Personal G70213142T.
- Z. **Fabrizio Orlandoni**, qytetar italian, i biri i Orlando, lindur në Marsciano (PG) Itali, më 29.08.1964, me vendbanim në Fatta Todina (PG) Itali, Strada Vicinale di Carbone, 4, me kartë identiteti italiane nr. AX9536267 e leshuar nga Komuna e Fratta Todina (PG).
- Z. **Gabriel Mencacci**, qytetar italian, i biri i Giuseppe, lindur në Marsciano (PG) Itali, më 28.08.1973, me vendbanim në Fratta Todina (PG) Itali, Via del Pisciarelllo, 16, me kartë identiteti italiane nr. AV3980582 e leshuar nga Komuna e Fratta Todina (PG)

të cilët kanë pranuar dhe deklaruar paraprakisht se në ngarkim të tyre nuk ekziston asnjë pengesë ligjore për të mos tu zgjedhur.




- 8.2 Administratorët, në rast se nuk është parashikuar ndryshe nga Asambleja, qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh, ose deri në shkarkim apo dorëheqje dhe kanë të drejtën për tu rizgjedhur.
- 8.3 Administratorët do të mund të ushtrojnë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet e përcaktuara në këtë Akt Themelimi dhe/ose nga neni 14 i Statutit.
- 8.4 Administratori z. **Roland Profiti** me kompetenca drejtimi dhe koordinimi do të mund të ushtrojë veçmas të kompetencat si më poshtë

- **kompetencat e drejtimit dhe e koordinimit:** administratori kryen çdo akt ligjor të qenësishëm për qëllimin e Shoqërisë, që ka të bëjë me organizimin e brendshëm të shoqërisë; administratori vepron në mënyrë të pavarur, në përputhje me objektin e shoqërisë dhe statutin. Veçanërisht:
 - Përcaktimi dhe zbatimi i formës më të përshtatshme organizative të korporatës;
 - Përzgjedh dhe menaxhon stafin e duhur në sasi dhe aftësi;
 - Organizimi i objekteve dhe pajisjeve të përshtatshme për qëllimin;
 - Të ndjekë dërgesat me sasi dhe oraret e pritshme;
 - Menaxhimi i përgjithshëm i prodhimit dhe i impianteve industriale, i të gjithë personelit, duke përfshirë sigurinë e përgjithshme të personelit, pronën, mbrojtjen e mjedisit të punës dhe mbrojtjen e mjedisit;
 - Rregullojnë kostot dhe të ardhurat për të ndjekur rezultatet ekonomike, financiare dhe zhvillimin e shoqërisë, sipas përcaktimeve të buxhetit përkatës;
 - Mban librat dhe regjistrimet kontabël të shoqërisë, duke u kujdesur për përgatitjen e pasqyrave financiare dhe dorëzimin e tyre për miratim në kuvend;
 - Monitoron performancën e përgjithshme të Shoqërisë, duke parandaluar ngjarjet paragjyquese dhe duke kërkuar zgjidhje kur ato ndodhin.
- **Kompetenca e nënshkrimit dhe përfaqësimit:** Administratori Z. **Roland Profiti** ka kompetencën të nënshkruajë të gjitha aktet që kanë të bëjnë me Shoqërinë dhe të përfaqësojë vullnetin e Shoqërisë përkundrejt të tretëve.

Në veçanti, Administratori:

- Merret me administrimin e zakonshëm të shoqërisë, është përgjegjësi e administratorit të hartojë pasqyrat financiare të shoqërisë dhe të thërrasë mbledhjen e ortakëve për miratimin e saj dhe në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji shqiptar ose nga Statuti i Shoqërisë;
- Mund të ushtrojë veçmas të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, përfaqësimit ligjor të Shoqërisë pranë autoriteteve, enteve publike, institucioneve të sigurimeve shoqërore dhe të shëndetësore, organit tatimor, autoriteteve doganore dhe institucioneve të kreditit;
- Do të mund të sigurojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, vetëm me nënshkrimin e tij, lidhjen e kontratave të punës me afat të caktuar dhe të pacaktuar, për emërimin dhe ngjitjen në detyrë dhe rritjen e shpërblimit, si dhe për zgjidhjen e tyre, të punonjësve të çdo kategorie dhe grade me një kosto mujore deri në maksimum € 1.500,00 (njëmijëepesëqind euro / 00), ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, brenda kufijve të Buxhetit.

- 
- Të gjitha kontratat e punës me afat të caktuar dhe të pacaktuar me një kosto mujore të ndërmarrjes më të madhe ose të barabartë me € 1.500,00 (njemijëepesëqind euro / 00) duhet të përcaktohen me nënshkrim të përbashkët me një nga administratorët e tjerë në detyrë, gjithmonë në kufijtë e buxhetit

- **Llogari rrjedhëse, kredi,**

I. të krijojë, modifikojë dhe shlyejë, me bankat, institucionet e kreditit në përgjithësi dhe zyrat postare, kreditimin, llogarinë rrjedhëse, depozitën, marrëveshjet e paradhënies, gjithashtu të garantuara me letra me vlerë, mbrojtje me norma interesi, kasaforta, të kërkojë dhe/ose modifikojë linjat e kreditit afatshkurtër si dhe të negociojë të gjitha termat dhe kushtet e linjave të kreditit që bankat dhe institucionet e kreditit do të duan t'i japin Shoqërisë, duke përfshirë qiratë financiare;

II. të kërkojë linja të zakonshme krediti dhe/ose dhënie fondesh (për shembull, *hot money*) brenda kufirit prej 500,000.00 € (pesëqind mijë euro / 00) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, pranë institucioneve të kreditit dhe/ose financat ose Shoqërite e qirasë financiare;

III. nxjerr urdhëra për pagesat bankare dhe autorizon çdo transaksion tjetër debiti nga llogaritë rrjedhëse të Shoqërisë, brenda kufijve të linjave të kredisë të dhëna, me një limit prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro / 00) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, me nënshkrim i vetëm dhe për një operacion të vetëm; dhe deri në 75,000.00 € (shtatëdhjetëepesëmijë / 00 euro) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, me nënshkrim të përbashkët me një nga Administratorët e tjerë në detyrë;

- **Blerjet**

I. blejnë, shkëmbejnë dhe shesin, si pjesë e programit të administrimit të zakonshëm të Shoqërisë dhe vlerësimeve të preventivave të kostove të parashikuara në buxhet, pasuri të luajtshme, duke përfshirë makineri, mallra, produkte gjysëm të gatshme, si dhe kryerjen e veprimtarive që lidhen me transportin dhe shërbime logjistike edhe në lidhje me ruajtjen dhe depozitimin e produkteve, mallrave dhe makinerive në përputhje me rregulloret dhe procedurat në fuqi; të gjitha për një shumë maksimale prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro / 00) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, me nënshkrim të vetëm, për çdo transaksion;

- **Kontratat**

I. Pa paragjykuar pikat "Llogaritë rrjedhëse, "hua" dhe "Blerjet" më sipër, negociacion dhe përfundon me kushtet që gjykohen më të përshtatshme duke përfshirë atë të arbitrazhit, kontrata të të gjitha llojeve dhe llojeve për një kohëzgjatje jo më shumë se 1 vit, të gjitha për një shumë maksimale prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, me nënshkrim të vetëm, për çdo kontratë të vetme.

II. Të gjitha kontratat me kohëzgjatje më të madhe se 1 (një) vit ose për një shumë që tejkalon 10,000 euro (dhjetë mijë euro / 00) dhe deri në 50.000 euro (pesëdhjetë mijë euro / 00) maksimale, ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, me nënshkrim të vetëm, për çdo kontratë të vetme, duhet të nënshkruhen me firmën e përbashkët me ndonjë Administrator tjetër në detyrë.

- Si shembull dhe pa u kufizuar në, mund të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit së zakonshëm veçmas, me një limit për çdo transaksion brenda shumës maksimale prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro / 00) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, marrë individualisht ose nëse e ndarë që i atribuohet një marrëveshjeje të vetme. Ndërsa për shuma më të larta dhe brenda



kufirit maksimal prej 75,000.00 € (shtatëdhjetëepesë mijë / 00 euro) ose një shumë me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër, e marrë individualisht ose nëse e ndarë që i atribuohet një marrëveshjeje të vetme, me nënshkrim të përbashkët me ndonjë Administrator tjetër në detyrë

- Me përjashtim të kufizimeve të kompetencave të sipërpërmendura Administratori **Roland Profiti**, mund të ushtrojë veçmas të gjitha kompetencat në përputhje me përcaktimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe Statutin.

8.5 Administratori z. **Fabrizio Orlandoni** dhe Administratori z. **Gabriele Mencacci** do të mund të ushtrojë veçmas:

- a) të gjitha kompetencat e përfaqësimit institucional të Shoqërisë përkundrejt Enteve publike si dhe privateve në përgjithësi, në zbatim të politikave tregtare të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë;
- b) do të mund të ushtrojë mbikëqyrjen e funksionimit të shoqërisë, mbarëvajtjen e porosive si në aspektin sasior ashtu edhe cilësor, kontrollin e menaxhimit dhe verifikimet që lidhen me to dhe vijën si pasojë e tyre.
- c) Ata do të mund të ushtrojë bashkarisht duke nënshkruar për konfirmim aty ku kërkohet për veprimtaritë e Administratorit tjetër në detyrë

8.6 Administratorëve u jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer veçmas formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratorët, mund t'u drejtohen për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.7 Administratorët janë gjithashtu të autorizuar të veprojnë veçmas në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ata janë gjithashtu të autorizuar, të firmosin të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe kanë të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

Neni 9 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

9.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

9.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen gjyqates së Durres.

Neni 10– Gjuha

10.1 Ky Akt Themelimi është hartuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.




10.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin e akteve si më lartë, versioni në shqip do të jetë i vetmi version ligjërish detyrues.

Palët e lexuan këtë Akt Themelimi në prani të përkthyeses e Znj. Gerta Ylli dhe e pasi e deklaruan atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre e nënshkruajnë atë në vijim.


ORTAKET

per Shoqerine "EMU Group" S.p.A.


z. Giorgio Comodi


z. Roland Profiti

PERKTHYESE


z. Gerta Ylli

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SHADE” Sh.p.k.

Sot më datë 22.06.2022, në Tiranë palët e mëposhtme:

- Shoqëria “**EMU Group**” S.p.A., shoqëri e se drejtes italiane, e regjistruar ne regjistrin e shoqërive ne Perugia, Itali, me kod fiskal dhe numer te regjistrimit: 03765320969, me seli ligjore ne Zona Industriale Schiavo, Marsciano (PG), CAP 06055, Itali, e perfaqesuar nga perfaqesuesi i saj ligjor z. Giorgio Comodi, qytetar italian, i biri i Giovanni, i datëlindjes 17.10.1958 mbajtës i katës së identitetit Italiane Nr. AY 7875357 e leshuar nga Komuna e Marsciano, autorizuar me Vendim te Keshillit te Administrimit date 17.05.2022 i pajisur me apostille n. 930/2022, madhor dhe me zotësi juridike te plote për të vepruar;
- z. **Roland Profiti**, qytetar shqiptar, i biri i Jorgji, i datëlindjes 13.02.1967 , banues ne Lagjia 16, Rruga “Hysen Kertusha”, Banese Private, Durrës me leternjoftim shqiptar me Nr. 033854608 dhe Nr. Personal G70213142T madhor dhe me zotësi juridike te plote për të vepruar.

kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KAPITULLI I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 – Forma


- 1.1. Shoqëria “**SHADE**” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 – Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “**SHADE**” Sh.p.k.

Neni 3 – Objekti i shoqërisë

- 3.1. Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve prodhuese e tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
- 3.2. Në mënyrë më specifike, Shoqëria ka për objekt: (i) prodhimin e çadrave, pjergullave, belvederëve, velave dhe mbulesave në përgjithësi; (ii) kryerje përpunimi mekanik dhe tapiceri për llogari të palëve të treta; (iii) import eksporti e lidhur me aktivitetin; .
- 3.3. Shoqëria mund të kryej çdo aktivitet tjetër të nevojshëm, të dobishëm ose funksional për realizimin e qëllimeve të shoqërisë sipas nenit 3.1 më sipër.



Neni 4 – Selia

- 4.1. Selia e Shoqërisë është Xhafzotaj, Ndertese me Numer Pasurie 49/58-ND, Zona Kadastrale Nr. 3852, Vol. 17, Faqe 50, Durres, Shqipëri.
- 4.2. Transferimi i selisë së Shoqërisë në një vend tjetër bëhet me vendimin e Asamblesë së Ortakëve, jo me pare se 4 vjet nga fillimi i aktivitetit.
- 4.3. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë, hapjen e filialeve, selive dytësore, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë, dhe jashtë shtetit. Asambleja e Ortakëve mund t'ia delegojë këtë kompetencë organit administrativ.

Neni 5 – Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me afat te pacaktuar.
- 5.2. Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KAPITULLI II


KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 – Kapitali themeltar

- 6.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është € 300 000,00 (treqind mijë/00 euro)..
- 6.2. Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, të gjitha të nënshkruara, me vlerë sipas nenit 7 të Statutit.

Neni 7 - Kontributet

- 7.1. Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:
 - Shoqëria "EMU Group" S.p.A., ka ofruar një kontribut në para të barabartë me € 195.000 (njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë / 00 euro) në favor të shoqërisë në themelim e sipër në këtë mënyrë: shuma prej € 130.000 (njëqind e tridhjetë mijë euro), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Intesa SanPaolo Bank Sh.A, në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe pjesa e mbetur prej € 65.000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë euro) do të dredhet brenda datës 31.12.2023.
 - Z. Roland Profiti, ka ofruar një kontribut në para të barabartë me € 105.000 (njëqind e pesë mijë / 00 euro) në favor të shoqërisë në themelim e sipër në këtë mënyrë: shuma prej € 70.000 (shtatëdhjetë mijë euro), nëpërmjet depozitimit pranë Bankës Intesa SanPaolo Bank Sh.A, në favor të shoqërisë në themelim e sipër; dhe pjesa e mbetur prej € 35.000 (tridhjetë e pesë mijë euro) do të dredhet brenda datës 31.12.2023.
- 7.2. Sipas kontributeve të mësipërme:
 - Shoqëria "EMU Group" S.p.A., i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 65% (gjashtëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.



- Z. Roland Profiti, i përket 1 (një) kuotë, që i korrespondon 35% (tridhjetëepesë përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

- 8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë në përputhje me legjislacionin në fuqi, me vendim të Asamblesë së Ortakëve që është e nevojshme për ndryshimin e Statutit.
- 8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre. Ortakët duhet ti komunikojnë me shkrim Shoqërisë dhe ortakëve të tjerë vendimin në lidhje me ushtrimin e të drejtës së nënshkrimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e publikimit të vendimit të Asamblesë së Ortakëve pranë Regjistrat Tregëtar. Në rast të kundërt do të kuptohet se është hequr dorë nga e drejta e nënshkrimit.
- 8.3 Në rast se disa nga ortakët nuk nënshkruajnë rritjen e kapitalit, pjesët e kapitalit të pa nënshkruara mund të nënshkruhen brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga perfundimi i afatit të parashikuar nga neni 8.2 nga ortakët e tjerë që kanë ushtruar të drejtën e tyre proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre, ose në rast se ata nuk kanë për qëllim që ti nënshkruajnë, pjesët e kapitalit të pa nënshkruara mund ti ofrohen të treteve për ti nënshkruar brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Në rast të kundërt do të kuptohet se është hequr dorë nga e drejta.
- 8.4 Nëse kapitali themeltar nuk është nënshkruar tërësisht, brenda afatit të parashikuar nga neni 8.3, kapitali do të rritet në një vlerë të barabartë me pjesët e nënshkruara vetëm nëse është parashikuar shprehimisht nga vendimi i rritjes së kapitalit.
- 8.5 Nuk mund të kryhet asnjë rritje tjetër kapitali nëse kuotat e emetuara më parë nuk janë shlyer tërësisht.

Neni 9 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve që është i nevojshëm për ndryshimin e Statutit. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 – Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ose përkundrejt shoqërive të cilat kontrollohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë prej tyre.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshëm nga ortakët ose nga shoqëri të cilat kontrollohen drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë prej tyre, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotat e tij të kapitalit duhet t'i njoftojë

ortakët e tjerë, me letër rekomandë me kthim përgjigje (në vijim "Njoftimi"), (a) numrin e kuotave të ofruara; (b) emrin e blerësit/përfituesit; (c) çmimin e rënë dakort për çdo kuotë, i përcaktuar në çdo rast në para, ose në vlerën në para në rast të një kundërshtëpërblimi tjetër të mundshëm (në rast shkëmbimi, kompensimi vullnetar, transaksioni, dhe çdo rast tjetër transferimi me shpërblim), ose vlerën e objektit të transferimit në rastin e transferimit pa shpërblim; (d) modalitetet e pagesës; (e) ftesën për të ushtruar të drejtën e parablerjes. Afatet dhe kushtet e mundshme për të cilat është rënë dakort midis transferuesit të kuotave dhe blerësit/përfituesit nuk do të jenë detyruese për ortakët e tjerë të cilët do të ushtrorjnë të drejtën e parablerjes. E drejta e parablerjes i referohet të gjitha kuotave të kapitalit ofruar për shitje.

- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e Njoftimit, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e ofruara nga ortakët që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrorjë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat e ofruara në njoftim mund t'u transferohen të tretëve sipas çmimit të specifikuar në të.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11 – Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkates.

Neni 12 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave të nënshkruara dhe shlyera që ai zotëron.
- 12.2 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim vetëm për një pjesë të kapitalit që zotëron.

Neni 13 – Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit/ve, dhe/ose ekspertit kontabël (nëse është emëruar) si dhe të inventarit.

- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga njëri prej Administratorëve me iniciativën e tij ose sipas kërkeses me shkrim që do tu drejtohet Administratorëve nga një ose disa prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje, dhe/ose me email që duhet t'u dërgohet ortakëve dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, edhe jashtë shtetit.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mbledhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes ose noteri publik.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.7 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë dhe ato për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar janë të marra rregullisht dhe janë vendime të vlefshme nëse janë të pranishëm dhe votojnë ortakët me të drejtë vote që zotërojnë respektivisht kuorumin konstitutiv dhe mazhorancen vendimarrëse sipas parashikimeve të neneve 86 dhe 87 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 13.8 Në çdo rast, Asambleja e Ortakëve vendos, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e të gjithë kapitalit themeltar për këto vendime: ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, transferimin e kuotave, shpërndarjen e fitimeve dhe të rezervave, riorganizimin, bashkimin, ndarjen, likuidimin dhe prishjen e shoqërisë, blerjen ose transferimin e pjesëmarrjeve, ndermarrjeve, degeve të ndermarrjeve, leshimin e garancive reale.
- 13.9 Në çdo rast, Asambleja e Ortakëve vendos, me votën pro të ortakëve që zotërojnë të paktën 51% (pesëdhjetë e një përqind) e të gjithë kapitalit themeltar për këto vendime:
- i) Përcaktimin e udhëzimeve dhe objektivave që do të zhvillohen në planin e biznesit dhe në buxhetin vjetor;
 - ii) Miratimin e planit të biznesit dhe buxhetit vjetor të Shoqërisë;
 - iii) Emërimin, heqjen e kompetencave dhe shpërblimin e administratorëve;
 - iv) Blerjen ose cedimin e aseteve për një vlerë me të lartë se € 50.000,00 (pesëdhjetëmijë/00 euro), ose të një shume me vlerë të barabartë në një monedhë tjetër;

- v) Lidhjen dhe zbatimin e marrëveshjeve Joint Venture midis shoqërive;
- vi) Marrja e kredive afatmesme ose afatgjata mbi €100,000.00 (njëqind mijë / 00 euro) ose një shumë me vlerë të barabartë në valutë tjetër, gjithashtu në formën e qirasë financiare dhe kredive aktive dhe pasive afatmesme dhe afatgjata;
- vii) Punësimi, emërimi, shpërblimi dhe shkarkimi i drejtorëve të përgjithshëm dhe drejtuesve;
- 13.10 Me përjashtim të parashikimeve të neneve 13.7, 13.8 dhe 13.9 më sipër, në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve të pranishëm, të parashikuar nga Ligji 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".
- 13.11 Çdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.12 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrrohet nga një ose më shumë Administratore, me kompetenca të përbashkëta ose veçmas. Administratorët në rast se nuk është parashikuar ndryshe nga Asambleja qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh ose deri në shkarkim apo dorëheqje dhe kanë të drejtën për tu rizgjedhur.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit të vetëm ose Administratoreve, bashkarisht ose veç e veç. Administratori/ët mund të ushtroj/në të gjitha fuqitë konform me sa parashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare*" dhe në çdo rast duke respektuar kufizimet e përcaktuara në aktin e tyre të emërimit dhe/ose nga ky Statut.
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posaçëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.

Neni 15 – Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare

të Biznesit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.

- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asamblejamund të vendosë zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KAPITULLI V SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

Neni 18 – Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe

do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara

- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen gjykatës së Durres.


Neni 21 – Gjuha


- 21.1 Ky Statut është hartuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe me shtojcë përkthimin në gjuhën italiane.
- 21.2 Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, versioni në shqip do të jetë i vetmi dhe do të jetë ligjërish detyrues.

Palët e lexuan këtë Statut në prani të përkthyeses e Znj. Gerta Ylli dhe e pasi e deklaruan atë në përputhje të plotë me vullnetin e tyre e nënshkruajnë atë në vijim.


ORTAKET

per Shoqerine "EMU Group" S.p.A.


z. Giorgio Comodi


z. Roland Profit

PERKTHYESE



**ATTO COSTITUTIVO
DELLA SOCIETÀ A RESPONSABILITÀ LIMITATA
"SHADE" Sh.p.k.**



Oggi, 22.06.2022, in Tirana, le seguenti Parti:

- La Società "EMU Group" s.p.a. società di diritto italiano, iscritta presso la Camera di Commercio di Perugia con numero di registrazione e codice fiscale 03765320969, con sede legale in Zona Industriale Schiavo, Marsciano (PG), CAP 06055 , Italia, rappresentata dal suo legale rappresentante il sig. Giorgio Comodi, cittadino italiano, figlio di Giovanni, nato il 17.10.1958, residente in Marsciano (PG), Italia, con carta d'identità n. AY 7875357 rilasciata dal Comune di Marsciano, autorizzato con Delibera CdA del 17.05.2022 munito con timbro apostille n. 930/2022, maggiore e con piena capacità di agire; e
- il sig. Roland Profiti, figlio di Jorgji, nato il 13.02.1967, residente in Lagjia 16, Rruga "Hysen Kertusha", Banese Private, Durrës, Albania, con carta d'identità albanese 033854608 e numero personale G70213142T, maggiore e con piena capacità di agire.

le quali hanno deciso di stipulare il seguente Atto Costitutivo di una società a responsabilità limitata, (di seguito "Società") la cui attività verrà regolata dalla legislazione Albanese in vigore e dal suo Statuto che fa parte integrante di questo atto, al quale è stato allegato (cfr. All. 1)

Art. 1 - Denominazione

La denominazione della Società è "SHADE" Sh.p.k.

Art. 2 - Sede

La sede legale della Società è stabilita in Xhafzotaj, Ndertese me Numer Pasurie 49/58-ND, Zona Kadastrale Nr. 3852, Vol. 17, Faqe 50 Durrazzo, Albania.

Art. 3 - Durata

La durata della Società è stabilita per un periodo indeterminato.

Art. 4 – Oggetto sociale

- 4.1 La Società ha come oggetto sociale lo svolgimento delle attività produttive e commerciali in conformità con la legislazione albanese in vigore.
- 4.2 Più precisamente la Società ha come oggetto sociale: (i) la produzione di ombrelloni, pergole, gazebi, vele e coperture in genere; (ii) lavorazioni sia meccaniche che di tappezzeria per conto terzi; e (iii) le attività di import ed export connesse all'attività'.
- 4.3 La Società potrà compiere ogni altra attività necessaria, utile o funzionale al conseguimento delle finalità sociali di cui all'art. 4.1 sopra.

Art. 5 – Capitale sociale

- 5.1 Il capitale sociale è di 300.000 (trecentomila/00) Euro.

5.2. Il capitale sociale è composto da 2 (due) quote interamente sottoscritte, aventi un valore come indicato nell'art. 6 del presente Atto Costitutivo.



Art. 6 - Conferimenti

6.1 Il conferimento del capitale sociale avviene nel modo seguente:

- La Società italiana "EMU Group" S.p.A., conferisce, in danaro Euro 195.000 (centonovantacinquemila/00) a favore della costituenda Società nel modo seguente: Euro 130.000 (centotrentamila/00) mediante versamento di pari importo presso la Banca Intesa SanPaolo Bank Sh.A., intestato a favore della costituenda società; e quanto alla rimanenza pari ad Euro 65.000 (sessantacinquemila/00) verranno conferiti entro il 31/12/2023;
- Il sig. Roland Profiti conferisce, in danaro Euro 105.000 (centocinquemila/00) a favore della costituenda Società nel modo seguente: Euro 70.000 (settantamila/00) mediante versamento di pari importo presso la Banca Intesa SanPaolo Bank Sh.A, intestato a favore della costituenda società; e quanto alla rimanenza pari ad Euro 35.000 (trentacinquemila/00) verranno conferiti entro il 31/12/2023;.

6.2 Secondo i conferimenti sopracitati:

- alla società italiana "EMU Group" SpA. appartiene una quota, corrispondente al 65% (sessantacinque per cento) del capitale sociale; e
